

Gjëra të Vogla, Ndryshim i Madh (Pjesa 2 nga 4)

Gëzohem që keni ardhur për të festuar në familjen e kishës sonë. Kemi filluar një seri të re: **Gjëra të Vogla, Ndryshimi i Madh.**

Për ata që nuk ishin javën e kaluar, ajo që thashë ishte: Shpesh ndodh që kur shikon dikë që ka gjithçka në vijë ose ka arritur diçka që ti dëshiroje shumë të bëje, të vjen të pyesësh: "Çfarë është ajo gjë e madhe që bëri ai/ajo? Çfarë të bëj unë?"

Ajo që përsërita javën e kaluar është: **Gjërat e vogla, ato që nuk i shikon njeri, ato sjellin gjërat e mëdha që i dëshiron çdo njeri.**

Një nga gjërat e vogla që sjell ndryshim të madh është kur gjen një fjalë që të mban të fokusuar gjatë gjithë kohës.

Javën e kaluar, ju nxita të kërkonit një fjalë për veten tuaj, një fjalë që do të udhëheqë vitin tuaj. Kush nga ju ka kërkuar dhe ka gjetur një fjalë për veten e tij/saj? Kush ka zgjedhur fjalën që thamë javën e kaluar?

Forcohuni. *Perëndia... do t`ju bëjë të përsosur Ai vetë, do t`ju bëjë të patundur, do t`ju forcojë dhe do t`ju vërë themel. 1 Pjetrit 5:10*

Do të shikojmë dhe do të fokusohemi në mënyrën se si ta aplikojmë këtë fjalë në zona të ndryshme të jetës tonë dhe në zona të ndryshme të kishës. Sepse gjërat e vogla sjellin ndryshim të madh. Për këto aspekte do të flasim gjatë këtyre javëve.

Sot do të flasim për mendimet tona, një gjë që duket e vogël, por ka shumë rëndësi, sepse mendimet ndikojnë veprimet, veprimet e përsëritura krijojnë zakonet e jetës së përditshme dhe zakonet përcaktojnë të ardhmen tonë. Në lidhje me mendimet, ky është një varg shumë i fuqishëm:

Fjalët e urta 23:7a *'sepse, ashtu si mendon në zemër të tij, ashtu është ai...'*

E thënë ndryshe, nëse ti mendon se nuk mundesh, ka shumë mundësi që vërtet nuk do mundesh. Nëse mendon se nuk ke asgjë për të ofruar, ka shumë mundësi që nuk do sjellësh ndonjë ndryshim në jetën tënde dhe në rrethin tënd.

Por nëse mendon se mundesh, ka shumë mundësi që do ia dalësh. Nëse mendon se rreth teje ekzistojnë mundësi të reja, ka shumë mundësi që do i shikosh ato mundësi. Nëse beson se Perëndia është me ty dhe në anën tënde, do e ndjesh fuqinë dhe praninë e Perëndisë.

Pse? Sepse mendimet kanë shumë rëndësi.

Jeta gjithmonë do të marrë drejtimin e mendimeve më të forta që ke.

Kështu që, si fillim, bëjmë një audit të mendjeve tona, një kontroll të mendimeve tona. Dua që të mendoni se çfarë jeni duke menduar këtë javë, duke përdorur këtë lloj skeme nga 1 deri në 10.

Nga 1–10, mendimet e tua kanë qenë plot shqetësime apo mendime të qeta?

Për çfarë po shqetësoheshe këtë javë?

- Shkolla
- Çfarë do të thonë prindërit
- Femijët
- Mësuesi
- Shefi në punë
- Paratë

Kjo javë ka qenë plot shqetësime apo një javë e qetë? Si mund të jesh më i qetë? Kujto premtimet e Perëndisë dhe beso se Perëndia është në kontroll.

Nga ka anuar më shumë kjo javë?

Nga 1–10, mendimet e tua kanë qenë pozitive apo negative këtë javë që shkoi? Ka njerëz që kanë dhuntinë e negativitetit, por jo juve, ca të tjerë. Ata e shikojnë gjithmonë atë që nuk shkon, dallojnë gjërat negative dhe gabimet. Janë kritikë ndaj të gjithëve, hamendësojnë të keqen gjithmonë dhe janë të pakënaqur gjithmonë.

Një person thoshte: “Sikur të isha i martuar, atëherë do isha i lumtur.” U martua dhe tha: “Po të kisha fëmijë do isha i lumtur.” U bë dhe me fëmijë dhe tha: “Po të kisha disa fëmijë të tjerë do isha i lumtur.” Dhe e gjeti veten duke parë gjithçka negativisht.

Nga ana tjetër, pozitiv është ai që beson në të mirën dhe shikon mundësitë e mira. Në kishën tonë, në vend që të shikosh se çfarë nuk shkon, ti shikon sesi po punon Perëndia dhe thua: “Dua të përfshihem edhe unë në këtë festim, si mund të ndihmoj?” Edhe nëse ke patur një ditë të vështirë, beson që Perëndia është i mirë dhe Ai do bëjë që çdo gjë të bashkëpunojë për mirë.

Në cilën anë je më shumë: pozitive apo negative?

Gjatë ditës, mendimet e tua janë më shumë të lidhura me gjërat e kësaj bote apo me gjëra të perëndishme?

Nëse mendimet për gjërat e perëndishme nuk janë në nivelin 10, atëherë ky mesazh është i përshtatshëm për ty. Pse? Sepse mendimet përcaktojnë se kush do të bëhesh. Jeta gjithmonë do të marrë drejtimin e mendimeve më të forta që ke. *Ashtu siç mendon në zemrën e tij, ashtu është ai.*

Prandaj Perëndia e frymëzoi Palin të shkruante:

Romakëve 12:2 *'Dhe mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj, që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullnet i Perëndisë.'*

Mos u konformo me zakonet e kësaj bote në të cilën jetojmë; lejo që Perëndia të të transformojë në një person të ri. Dhe a e di si e bën Perëndia këtë? Duke ndryshuar mënyrën si mendojmë.

Lejo që Perëndia të të transformojë në një person të ri duke të ndryshuar mënyrën e të menduarit. Më pas, do të kuptosh dhe do të njohësh se cili është vullneti i Perëndisë për ty—një vullnet i mirë, i kënaqshëm dhe i përsosur. Dhe kjo ndodh duke filluar nga mendimet.

Po, si bëhet kjo në mënyrë praktike?

1. Nënshetroi mendimet e tua

Ja se çfarë i shkroi apostulli Pal kishës në Korinth, sepse ata po besonin shumë gënjeshtër.

2 e Korintasve 10:3-5 *'Sepse, edhe pse ecim në mish, nuk luftojmë sipas mishit, sepse armët e luftës sonë nuk janë prej mishi, por të fuqishme në Perëndinë për të shkatërruar fortesat, që të hedhim poshtë mendimet dhe çdo lartësi që ngrihet kundër njohjes së Perëndisë dhe t'ia nënshetrojmë çdo mendim dëgjësës së Krishtit,'*

Edhe pse jetojmë në këtë botë, lufta jonë nuk është si luftërat që bën kjo botë. Pra, nëse je i krishterë dhe i beson Krishtit, armët me të cilat lufton nuk janë si armët që përdor kjo botë. Ne kemi armë supernatyrore që Perëndia na ka dhënë, të cilat shkatërrojnë çdo fortifikim.

Fjala fuqishme në gjuhën origjinale është *dunamis*, nga e cila vjen fjala "dinamit." Ti dhe unë kemi një fuqi shpërthyes nga Perëndia për të shkatërruar çdo fortifikim.

Fjala "fortesë" në gjuhën origjinale është *okurōma*, që ka kuptimin e një burgu nga mashtrimi, një situatë ku jemi kyçur brenda për shkak se jemi mashtruar.

Kur mendon mendime të gabura, ti e ke burgosur veten sepse ke qenë i mashtruar nga mendime të pasakta.

Që i bie, cila është arma më e madhe e armikut tonë? Si është quajtur ndryshe Satani? Ai është quajtur "ati i gënjeshtërave." Ai përpiqet të na bindë të besojmë gjëra që nuk janë të vërteta. Por nëse ne besojmë këto gënjeshtër dhe ia përsërisim vetes, i fiksojmë ato në mendjet tona derisa ato kthehen në fortesa të ngulitura dhe të forta, duke na bërë të mos besojmë më në të vërtetën.

Sepse i ligu e di që nëse ne e dimë dhe e besojmë të vërtetën, Jezusi tha, "E vërteta do t'ju bëjë të lirë."

2 e Korintasve 10:5 *'që të hedhim poshtë mendimet dhe çdo lartësi që ngrihet kundër njohjes së Perëndisë dhe t'ia nënshtrojmë çdo mendim dëgjuesës së Krishtit.'*

Hedhim poshtë, i shkatërrojmë këto mendime. Pjesa e nënvizuar, *dhe t'ia nënshtrojmë çdo mendim dëgjuesës së Krishtit.'*

Hedhim poshtë gënjeshttrat dhe ia nënshtrojmë mendimet dëgjuesës së Krishtit. Që i bie, kur ti mendon gënjeshttra të tilla, “Unë nuk bëj dot asgjë, unë jam koti, unë s’do arrij gjë në jetë, kështu kam për të qenë,” çfarë duhet të bësh? Ti i hedh poshtë këto gënjeshttra dhe i bindesh asaj që thotë Krishti.

Pra, e para është, ia nënshtrojmë mendimet, i sjellim, i paraqesim para Krishtit për të parë nëse janë të vërteta apo janë mashtrime të të ligut. Nëse janë mashtrime, i hedhim poshtë, i shkatërrojmë dhe...

2. Fokusohe mi në gjërat shpirtërore, të perëndishme.

Një nga vargjet shumë të veçanta të Biblës vjen nga Pali kur ai ishte në burg:

Filipianëve 4:8-9 *'Së fundi, vëllezër, të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë të mirë, nëse ka ndonjë virtyt dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni. Ato gjëra që keni mësuar, marrë dhe dëgjuar nga mua dhe patë në mua, i bëni, dhe Perëndia i paqes do të jetë me ju.'*

Pra, i nënshtrojmë gënjeshttrat dhe fokusohe mi te ajo që është e vërtetë. Këto mendojmë, fokusohe mi te gjërat e perëndishme që i pëlqejnë Perëndisë.

Unë mund ta bëj, nëse vazhdoj të jem i lidhur dhe i varur te Perëndia. Unë mundem, me Të do ia dal.

A e kupton ndryshimin e të menduarit?

Ndryshimi i të menduarit, mund të të ndryshojë të ardhmen.

Ti mund të jesh në të njëjtën pikë, mund të jesh një mendim larg; vetëm një të menduar ndryshe të situatës ku je, dhe e gjithë jeta dhe e ardhmja jote mund të jenë totalisht ndryshe.

Në momentin kur ti ndalon së besuari gënjeshttrat e djallit dhe vendos të pranosh dhe besosh të vërtetat e Perëndisë për jetën tënde, të vërtetat do të të bëjnë ty të lirë.

“Mirë mirë, po ti mund ta bësh këtë gjë, por unë nuk mundem.” Jo, jo, ti mundesh. Ti e ke çfarë të duhet.

A di se ku është ndryshimi mes korbit dhe kolibrit? Korbi kërkon ku të gjejë ndonjë kafshë të ngordhur. Gjen diçka të ngordhur dhe për të është sikur i ka rënë bingo.

Po kolibri për çfarë po kërkon? Kërkon nektarin e luleve.

Në jetë ka gjëra të ngordhura dhe nektar lulesh vërdallë. Për çfarë je duke kërkuar ti? Nëse je i fokusuar te Perëndia dhe gjërat e perëndishme, po e gjete, çfarë do gjesh?

Është si të përqendrohesh se ku do ta orientosh mendjen.

Shiko diçka të bukur:

Motoja e makinës Porche:

Të gjithë e dëshirojnë por jo të gjithë mund ta kenë.

Pasi e dëgjova, unë shikoj porche gjithandej tani, më para nuk m'i kapte syri shumë, tani i shoh shpesh gjatë gjithë ditës.

Pse? Sepse kjo gjë ka qenë në mendjen time.

Nëse je duke kërkuar, dhe nëse je i përqendruar në gjërat shpirtërore, ato do t'i arrish. Po si bëhet kjo gjë? A ka ndonjë mënyrë të thjeshtë? Po, ka.

Që në mëngjes, në vend që të hapësh Instagramin, Facebook-un, apo emailet, hap Biblën. E ke në celular; sa nga ju e keni Biblën si aplikacion në celular? Nëse nuk e di sesi, pyet dikë para se të ikësh për ta shkarkuar në smartfonin tënd.

Filloje ditën me Fjalën e Perëndisë. Lexo vetëm një kapitull; nëse ke vendosur ta lexosh Biblën brenda një viti, lexo tre kapituj dhe mendja jote do të jetë e përqendruar në gjërat shpirtërore.

Pastaj bisedo me Perëndinë, që të jetë gjëja e parë në mëngjes.

“Po duhet të shkoj në banjo se e kam urgjent?” Mirë, shko, mbaro punë që të jesh më i qetë.

Por pastaj lutu. Lutja nuk duhet të jetë e gjatë, një orë apo e stërzgjatur, por lutje 2-3 minuta, lutje të tilla: “Perëndi, faleminderit për këtë ditë. Kjo ditë është dhurata jote për mua. Më ndihmo sot që të shkëlqej për Ty kudo që të jem. Më drejto dhe më mëso hapat e kësaj dite. Ruaji mendimet e mia sepse dua që mendja ime të jetë e përqendruar në gjërat që Të pëlqejnë Ty.”

Kur ti e fillon ditën në këtë mënyrë, po e gjete çfarë do të shikosh gjatë ditës: kafshë të ngordhura apo nektar? Do të shikosh qartë të bukurën dhe se ku po punon, ku po vepron Perëndia.

Më pas, ti ecën me këmbë për në shkollë, punë, ose merr autobus. Në vend që të dëgjosh muzikë popullore, dëgjo këngë që ngjajnë me këngët që dëgjon këtu.

Dëgjo, mbushe mendjen me këngë lavdërimi; aq më shumë këngët e reja janë gjithnjë e më të bukura, si mesazh, ashtu edhe si ritëm dhe stil muzike.

Kur gjatë ditës, ndodhin gjërat e mira, në vend që të thuash, “Uaa, sa i mirë që jam, çun i rrallë jam,” jepi lavdi Perëndisë: “Sa i mirë është Zoti im, faleminderit Zot që e lejeve të ndodhte kjo dhe ajo.” Dhe do ta shohësh Perëndinë të veprojë në jetën tënde dhe kudo rreth e qark teje.

Kur pronari, drejtori, ose shefi tregon sjellje të papërshtatshme, në vend që ta shash nëpër dhëmbë, lutu për të.

Kur dikush të kërkon diçka ose do të bisedojë, në vend që ta shikosh si një bezdi, shikoje si një mundësi për të ndikuar në jetën e atij personi.

Dhe sa herë që të përdorë Perëndia, aq më i ndjeshëm do të jesh ndaj veprimit dhe lëvizjes së Perëndisë, dhe befas do kesh më shumë energji dhe më shumë kohë për të bërë gjëra të tilla.

Pse? Sepse unë e di që çdo gjë e vogël që mendoj ka rëndësi. Sepse unë e di, ashtu siç mendon një person në zemrën e tij, ashtu është. Sepse unë e di:

Jeta gjithmonë do të marrë drejtimin e mendimeve më të forta që kam.

Prandaj, unë ia nënshtroj çdo mendim bindjes dhe dëgjësës së Krishtit. Dhe do t’i fiksoj mendimet e mia në gjëra që janë të pastra, të dashura dhe të mira.

Po si mund ta bëjmë këtë gjë, si mund ta përvetësojmë sa më mirë dhe të fokusohemi më shumë? Javën e shkuar fola për të pasur një fjalë që do t’ju drejtojë gjatë gjithë vitit. Sot dua të mendoni për një mendim. Një mendim të vogël që mund të sjellë një ndryshim të madh, shumë më të madh sesa keni menduar.

Sepse ti dhe unë e dimë: **Shpesh gjërat e vogla, ato që nuk i sheh askush, sjellin ndryshimet e mëdha që çdo njeri i dëshiron.**

Cili do të ishte një mendim i vogël që do ia përsërisje vetes herë pas here derisa mendja jote të përtërihet, ai mendim të zbresë në zemër dhe të ndryshojë atë që thua, atë që ndjen, dhe pastaj të ndryshojë mënyrën e të jetuarit?

Sepse nëse do të ndryshosh mënyrën sesi jeton, thjesht ndrysho mënyrën sesi mendon, apo jo? Një mendim që është i bazuar në të vërtetën e Perëndisë, një mendim që lidhet me premtimet e Perëndisë dhe jo me gënjeshttrat dhe të pavërtetat e të ligut.

Forcohuni. Mendimi mund të ketë lidhje me Fjalën ose me këtë varg, ose mund të jetë diçka tjetër. Kur fillova të shërbeja për herë të parë, për mua ishte: "Varu te Perëndia. " “Varu te Unë,” thotë Zoti.

Le të lutemi.